

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrustem Mustafa propozon “Koalicionin për Normalitet” për funksionalizimin e institucioneve
ADRESA	https://albeu.com/kosove/rrustem-mustafa-propozon-koalicionin-per-normalitet-per-funksionalizimin-e-institucioneve/1011527/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:48:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 18:46:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56d31b476ea07b611566e137c1066e087e5bd0a8ca05bf68de2b2f7f8428d657
TEKSTI	fd649970d77df7cbf8d46a40e753397576344afa700317295e53cc24be2304f5
PAMJA	38efd2ca004303fd009b95ebf9de533be0c2598698c810eac695c09b6e5c919c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d2ed2b075fc2c1b1aa9d46221fec31d791c3c98997fd602c80994ed3658921bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d2ed2b075fc2c1b1aa9d46221fec31d791c3c98997fd602c80994ed3658921bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rrustem Mustafa propozon “Koalicionin për Normalitet” për funksionalizimin e institucioneve



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rrustem Mustafa, ka hedhur në diskutim një platformë politike që synon zhblokimin e institucioneve të Kosovës. Ai ka bërë thirrje për arritjen e një marrëveshjeje mes Lëvizjes Vetëvendosje, PDK-së dhe komuniteteve joshumicë.

Përmes një shkrimi në Facebook, Mustafa ka deklaruar se vendi nuk ka nevojë për përshkallëzim të mëtejshëm politik, por për një dakordim që do t'i rikthente institucionet në funksion.

Propozimi i tij, i emërtuar “Koalicioni për Normalitet”, do të ishte pjesë e një “Pakti për Shtetin”. Sipas deputetit, kjo nismë duhet të mbështetet te tri elemente: legjitimiteti i LVV-së si forcë e parë parlamentare, roli balancues i PDK-së dhe përfaqësimi kushtetues i komuniteteve joshumicë.

Mustafa vlerëson se zgjidhja gjendet te vullneti politik i shumicës parlamentare të përbërë nga LVV, PDK dhe komunitetet joshumicë. Ai e ndan platformën në disa shtylla kryesore.

Shtylla e parë lidhet me legjitimitetin. Si partia me numrin më të madh të përfaqësuesve në Kuvend, LVV-së do t'i njihej drejtimi i institucioneve dhe përgjegjësia kryesore për udhëheqjen e Qeverisë dhe Kuvendit, në përputhje me vullnetin e qytetarëve.

Shtylla e dytë ka të bëjë me balancën institucionale dhe stabilitetin presidencial. Në këtë kuadër, PDK-ja do të merrte përsipër garantimin e kontrollit demokratik, ekuilibrit institucional dhe orientimit euroatlantik përmes një marrëveshjeje të qëndrueshme për ndarjen e përgjegjësisë. Si pjesë e këtij ekuilibri, partitë pjesëmarrëse në koalicion do të angazhoheshin që Presidenca të drejtohej nga PDK-ja.

Për komunitetet joshumicë, platforma parashikon garantimin e përfaqësimit të plotë dhe ushtrimin e rolit të tyre kushtetues në institucionet e Republikës së Kosovës.

të fundit /



VIDEO/ Jasir Asani ndez Champions-in aziatik, shqiptari...



Gola: Lirimi i katër ish-drejtimesve të UÇK-së do të ishte sukses i...



Gjashtë projekte Kosovë-Maqedoni e Veriut marrin financi...



Rama në Napoli për inaugurimin e Konsullatës së Nderit...



VIDEO/ Como triumfon ndaj Parmës dhe ngjitet përkohësisht në vend...



Roma nuk ndalet, katër fitore në katër javët e para pas suksesit nd...



Vetëvendosje reagon pas largimit të Bekim Sejdiut nga gara...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Deputeti e paraqet këtë nismë si një marrëveshje që kërkon përgjegjësi, jo heqje dorë nga legjitimiteti politik. Sipas tij, legjitimiteti i secilës palë duhet të ndërthuret me balancën e domosdoshme për krijimin e institucioneve funksionale.

Platforma përfshin edhe disa parime për orientimin strategjik dhe funksionimin e shtetit.

1. Partneriteti euroatlantik: Qeveria e Kosovës duhet të forcojë një bashkëpunim të qëndrueshëm, strategjik dhe efektiv me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n, të cilat Mustafa i cilëson si garanci për sigurinë kombëtare.

2. Vizioni kombëtar: Institucionet duhet të afrohen plotësisht me shtetin shqiptar dhe me shqiptarët në të gjithë rajonin, përmes ndërtimit të një platforme të përbashkët politike, ekonomike dhe kulturore.

3. Mbrojtja e vlerave çlirimtare: Shteti duhet të krijojë afërsi me çlirimtarët dhe të largojë çdo pengesë ligjore, propagandistike ose administrative që i mban ata larg institucioneve dhe narrativës zyrtare të shtetndërtimit.

4. Përgjegjësia shtetërore: Kryeministrit të Kosovës, sipas Mustafës, i është dhënë një mundësi historike për të ndërtuar politika kombëtare të drejta, vizionare dhe transparente, ndaj ai nuk duhet ta zhgënjejë më vendin.

Duke iu drejtuar kryetarit të LVV-së, Albin Kurti, Mustafa ka thënë se zgjidhja është në duart e tij. Ai i ka kërkuar Kurtit, si drejtues i forcës më të madhe parlamentare, ta nisë këtë proces dialogu.

Propozimi, sipas Mustafës, e njeh legjitimitetin e LVV-së, por njëkohësisht kërkon balancë dhe garanci për shtetin. Ai ka shprehur bindjen se PDK-ja është e gatshme të marrë përsipër pjesën e saj të përgjegjësisë.

Deputeti ka përsëritur se Kosova nuk ka nevojë për trazira apo kriza të reja politike, të cilat nesër mund të përdoren si arsye për pranimin e një realiteti që, sipas tij, mund të ndryshohet sot.

Mustafa beson se rruga alternative është një marrëveshje politike e mbështetur në përgjegjësi dhe vullnet për ndërtimin e një shteti normal. Ai e cilëson "Koalicinin për Normalitet" jo si kompromis me të ardhmen, por si detyrim ndaj vendit.

Në përfundim, ai ka theksuar se Kosovës i duhet mundësia për të ecur përpara dhe jo një tjetër krizë, duke bërë thirrje që kjo zgjidhje politike të shndërrohet në normalitet, zhvillim dhe perspektivë evropiane.

Mesazhin e tij, Rrustem Mustafa e ka përmbledhur me kalimin "nga bllokada te institucionet" dhe "nga përplasja te përgjegjësia".

Mustafa mban postin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Shtuar më 14.09.2026 20:46

Tags: [deputeti i pdk](#), [Rrustem Mustafa](#)



Gola: Lirimi i katër ish-drejtuesve të UÇK-së do të ishte sukses i Kosovës, j...



Gjashtë projekte Kosovë-Maqedoni e Veriut marrin financim prej 3.24 milionë...



Vetëvendosje reagon pas largimit të Bekim Sejdiut nga gara presidenciale



Kurti takohet me ambasadorin Hargreaves, vlerësohet puna për...



Vjosa Osmani me vlerësim për Bekim Sejdiun pas tërheqjes nga gara për...



EULEX-i rishikon masat e sigurisë në Kosovë para vendimit të 16 shtatorit



Ilir Deda: Tërheqja e Bekim Sejdiut i kushtoi Kosovës një tjetër model...



Arben Gashi: Gjykata Kushtetuese vendos për hapat e ardhshëm pas...

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.